

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"BAU NORD" SHPK**

Sot më datë 04.06.2020 (dymijë e njezet), themeluesit :

BAU GROUP Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar rregjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit në numer NUIS M01728004A me adresë **Tirane, Kashar, Rruga Dhaskal Todri, Godina nr 33, 1051, KATI II**, përfaqësuar rregulisht nga **Z. Artan Beqiri** i biri Ismetit, lindur me 04.04.1972 në Sarandë, dhe banues në Tirane, Rruga Sami Frasheri, Pall 56, identifikuar me leternjoftim nr. BE1116161/ H20404069R, madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, në përputhje me vendimin nr.2 datë 01.06.2020, të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, e cila ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave të mëposhteme.

Andi Mula, i biri i Ilirit, lindur me 01.04.1978 në Shkoder, dhe banues në Shkoder, Bulevardi Zogu i I ,pallati 167, identifikuar me leternjoftim nr. BR4781459/ H80401106R

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008"Per tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe në ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 për Q.K.B, kërkoi redaktimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë vijon:

**NENI I
EMERTIMI I SHOQERISE**

1.1 Emri i shoqërisë është "**BAU NORD**" Shpk (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2
SELIA LIGJORE**

2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në Tirane, Shqipëri: **Shkoder, Shkoder 3, Rruga Çlirimi, Zona Kadastrale 8593, Numri i Pasurisë 3/1017-ND**

2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3



KOHEZGJATJA

3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar

NENI 4 OBJEKTI I SHOQERISE

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në baze të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në:

Në fushën e tregtisë import – eksporti, me shumicë dhe pakicë, të mallrave industriale, ushqimore, bujqësor dhe blegtorale, veshmbathje, konfeksione, prodhime e tregtim të materialeve të ndërtimit, inerte, rëre, zhavorr, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobileve, artikujve kozmetike, lendeve të përpunuara dhe të papërpunuara, e bimëve medicinave, të lendeve drusore, plastike, duraluminit, tregtim me pakicë të karburanteve dhe vajrave lubrifikante.

Në fusha të tjera: hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave të servilit, parkim automjetesh, lavazhit, hoteleve, fshatrave turistik, moteleve si dhe agjencive për shitblerje, dhënie me qira të pasurive të tundshme dhe të patundshëm, agjencive për shitblerje,

4.2 Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të vepronte në Shqipëri dhe jashtë, dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të lidhur, instrumental, të përafërt, elementar, ose sidoqoftë të dobishëm, për shembull:

Të ofroje garanci reale dhe/ose personale si për detyrime të vetat, ashtu edhe për të tretët. Të marrë përsipër, të lejojë dhe të heqë dorë nga pjesëmarrje direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe ndërmarrje, si Shqiptare ashtu edhe të huaja, që kryejnë veprimtarinë e tyre ana tyre, me qëllim që të lehtësojnë realizimin e objektit social; Veprimtari tregtare dhe industriale, import dhe eksport të mirash, shërbimesh dhe produktesh;

Në kuadër të ligjit, të krijojë veprimtari dhe filiale të përfaqësimit.

NENI 5 KAPITALI I SHOQERISE

5.1 Kapitali i Shoqërisë **BAU NORD Sh.p.k** është i barabartë me 1000 Leke (njemije Leke), i shlyer plotësisht, me para, nga ortakët si më poshtë:

1. **BAU GROUP Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar rregjistruar pranë Qëndresë Kombëtare të Biznesit në numer NUIS M01728004A me adresë **Tiranë, Kashar, Rruga Dhaskal Todri, Godina nr 33, 1051, KATI II,**



zoteron 1 (nje) kuote qe ne vlere eshte 600 Leke (gjashteqind Leke) qe perben (60%) te kapitalit fillestare.

2. **Z.Andi Mula** zoteron 1(nje) kuote qe ne vlere eshte 400 Leke (katerqind Leke) qe perben (40%) te kapitalit fillestare
- 5.2 Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotën përkatëse të pjesëmarrjes në Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë. Në rast se një nga ortakët dëshiron të kalojë/transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në Shoqëri, duhet t'ia ofrojë këtë kuotë për blerje ortakëve të Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortakët do të kenë të drejtën të blejnë kuotën e ofruar në shitje sipas çmimit dhe mënyrave të pagesës për të cilat kanë rënë dakord me ortakun shitës.
- 5.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

NENI6

KALIMI I KUOTES ME TRASHËGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT

- 6.1 Në rast vdekje apo falimentimi të njërit prej ortakëve, kalimi i kuotës dhe i të drejtave përkatëse në favor të trashëgimtareve apo personave që fitojnë këto të drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet të shprehet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit të ortakut. Në rast refuzimi të pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit të sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguaje trashëgimtareve apo personave që fitojnë këto të drejta vlerën e kuotës që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore të Shoqërisë dhe vlerën e tregut të kuotës.
- 6.2 Personi që fiton të drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut mund të zgjedhë të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës, ai njofton Shoqërinë në lidhje me këtë vendim.
- 6.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë për shkak të vdekjes apo falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruar i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si zotëruar i kuotës.

NENI 7
ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do të komunikohet me shkrim ortakeve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejte me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 7.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar prej tyre mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë serish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejte me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 8
ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.10 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 9
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakeve të Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokurë me shkrim .



- 9.4 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshire telekonferencën (conference call) audio ose video, ne përputhje me ligjin për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme do te quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratoret ose nga ortaket ne baze te nenit 84 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirrja e mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme duhet te behet nëpërmjet njoftimit me shkrim osgJ11e mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqërisë te paktën 7 (shtate) dite përpara datës se caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do te mblidhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortaket apo përfaqësuesit e tyre janë te pranishëm dhe bien dakord te vendosin ne lidhje me rendin e dites.
- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme kryesohen nga Administratoret. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje nder personat e pranishëm.
- 9.7 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 9.9 Asambleja e Pergjithshme, perveçse per sa parashikon neni 9.10 i ketij Akti Themelimi dhe Statuti, per vendime qe kerkojne shumicen e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote ose perfaqesuesit e tyre, qe zoterojne me shume se 30% (tridhjetë per qind) te kapitalit te Shoqerise, sipas nenit 86 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqerite tregtare".
- 9.10 Asambleja e Pergjithshme vendos me votat pro te te pakten 51 % te ortakeve pjesemarres (shumica e kualifikuar) ne baze te nenit 87 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqerite tregtare", per ndryshimin e ketij Akti Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.



NENI10
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori/et i cili/te cilët për një periudhë prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori/et mund të rizgjidhen dhe shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 1 administrator: **Andi Mula**
- 10.2 Administratori/t zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç veprimeve, përmbushja e të cilëve i rezervohet Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe mund të autorizojë persona të tretë, për të përmbushur veprime të caktuara, në emër dhe për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, administratori do të jetë përgjegjës për veprimet e të tretëve të autorizuar.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratoreve të shoqërisë.
- 10.4 Administratoret nuk do të mund të marrin hua nga Shoqëria ose të lëshojnë garanci, dorëzani, në emër dhe për llogari të Shoqërisë, për hua dhe financime të dhëna nga të tretët.
- 10.5 Administratoret do të veprojnë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

NENI11
VITI FINANCIAR

- 11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI12
KONTROLI FINANCIAR

- 12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël të Autorizuar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Eksperte Kontabël të Autorizuar në atë rastë kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 13
BILANCI VJETOR



- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e përgjithshme .
- 13.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 14
DIVIDENDET

- 14.1 Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve në bazë të rezultatit financiar të shoqërisë.

NENI 15
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 15.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, administratoreve, likuiduesit, do t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.


NENI 16
GJUHA

- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplare në gjuhën shqipe.

NENI 17
DISPOZITA PERFUNDIMTARE

- 17.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi dhe Statut, do të zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

ORTAKU
I
SHOQERISE
BAU NORD SH.P.K


Artan Beqiri
BAU GROUP SH.P.K
Perfaqesuesi ligjor

ORTAKU
I
SHOQERISE
BAU NORD SH.P.K


Andi Mula